



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1040

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE “HM Home” SH.P.K., kundër njoftimit për kontratë ose dokumentet të tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi” me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”, më 27/11/2025, mori këtë:

Vendim

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e “HM Home” SH.P.K. me nr. 2025/1040, e datës 20/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi”, me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”.

2. **Vërtetohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi” me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Lejohet AK të vazhdojë me procedurën e prokurimit.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e pjeserisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.07.2025, "KOMUNA E PRISHTINËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me nr.prokurimi: 616-25-6903-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për furnizim, kriteri dhenjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00€.

Me 15.10.2025, OE "HM Home" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 17.10.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.10.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "HM Home" SH.P.K me nr. 2025/1040 lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me numër të prokurimit: 616-25-6903-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "HM Home" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Komunës së Prishtinës të datës 17.10.2025, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik HM HOME SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 Shtatori" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Operatori ekonomik e konsideron këtë vendim të pabazuar në fakte dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, meqë Komuna ka vepruar në mënyrë të përsëritur duke favorizuar operatorin ekonomik "Wood Corporation L.L.C."

Ky nuk është tenderi i parë që është përgatitur në mënyrë të dukshme për këtë operator, duke krijuar dyshim të bazuar për konflikt interesi dhe korrupsion aktiv nga zyrtari i prokurimit Visar

Shehu.

Si dhe Autoriteti kontraktues KUVENDII KOMUNES SE PRISHTINES ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Furnizimi dhe montimi i inventarit për objektin e ri administrativ me nr. të prokurimit: 616-25-6903-1-1-1. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat haptas favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar pasi që të njëjtat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit sepse kërkesat nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë. Autoriteti kontraktues tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale në nenin 7.1&7.2 në pikën 3 ka kërkuar:

Kërkesa 3:

Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me ISO Certifikatat valide ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata Evidenca3: Certifikatat valide ISO 9001- 2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata Në pikën nr. 3 ka kërkuar kërkesat për certifikatat ISO 9001 2015; ISO 14001-2015; ISO 45001 2018; ku të njëjtat Certifikata i ka kërkuar të jen valide mirpo nuk ka kërkuar të jen Certifikata të noterizuara pasi që këtu mund të vihet në lajthitje Autoriteti Kontraktues nga Operatori Ekonomik të cilit i është pregaditur ky tender pasi që ato mund edhe të falsifikohen si dhe janë certifikata të cilat nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e prokurimit në fjalë pasi që ISO 9001-2015 ka të bëjë me SISTEMIN E MENAXHIMIT TE CILESISE pra fare ska të bëjë me furnizimin me inventar por me menaxhimin e sistemit të cilësisë pra është natyrë tjetër ndërsa ISO 14001- 2015 ka të bëjë me SJSTEMIN E MENAXHIMIT MJEDISOR fare ska të bëjë me furnizimin me inventar por ndihmon që organizatat të menagjojnë ndikimin e tyre në mjedis, të përmbushin detyrimet ligjore dhe të përmisojnë vazhdimisht performancën mjedisore si edhe ISO 45001 2018 ka të bëjë me SISTEMI MENAXHIMIT TE SHENDETIT DHE SIGURISE NE PUNE MJEDISOR fare ska të bëjë me furnizimin me inventar por ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë jep një kornizë që organizatat të përmisojnë sigurinë e punonjësve që të ulin rrezikun dhe të krijojnë kushte me të mira e më të sigurta për punë.

Pra ky kriter me këto certifikata të kërkuara duhet të hiqet menjëher pasi që fare ska të bëjë me furnizimin me inventar prandaj haptas autoriteti kontraktues po e kufizon konkurrencën ndërsa shumë qartë shihet se janë vendosur për operator ekonomik të paracaktuar. KU OSHP KA NXIERR VENDIM PËR HEOIEN E KËTII KRITERI,

Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet të jete i Autorizuar nga Prodhuesi për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65, 66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80. Evidenca 4 Autorizim nga Prodhuesi -kopje. Në pikën nr. 4 Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat favorizojnë ndonjë Operator Ekonomik pasi që nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë. Përkatesisht pozitat 58,59,60,61,62,64, 65, 66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80. Pasi që duke e ditur që inventari medicinal nuk prodhohet në Kosovë dhe

njedhimisht nuk mund te behet "costum made" atehere duhet te lejohet qe dimensionet dhe specifikat te ndryshojne se kaku +/-10 % ne menyre qe te mundesohet sa me shume pjesemarrja e O.E. dhe prezantimi i brendeve te ndryshme kerkesa qe per pozicione e lartcekura te paraqitet autorizimi i prodhuesit te autorizuar e kufizon skajshmerisht konkurencen pasi qe e drejton tregun per furnizim te këtyre materialeve vetem nga nje prodhues i parazgjedhur. Gjithashtu nga AK jane paraqitur specifikat teknike te pershtatura pikeperpike per nje prodhues. Kjo eshte ne kundërshtim me Neni 28 te LPP-s - Specifikimet teknike - pasiqe per arsye te pershtatjes pike per pike te specifikimeve teknike te produkteve te prodhuesit "Turmed" per pozicionet. 58,59,60,61,62,64, 65, 66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 nuk eshte lene mundesia qe te konkurohet me produkte nga prodhuese tjere. Andaj me kete specifikim teknik eshte ngushtuar pjesemarrja e Operatoreve Ekonomik te tjere gjegjesisht edhe prodhuesve te tjere me renome boterore. si dhe Autorizimi eshte kerkese e cila eshte ne kundërshtim edhe me nenin 69 te LPP-s pasi qe ne asnjerin nga dispozitat e ketij neni nuk eshte dhene mundesia per te kerkuar autorizimin e prodhuesit per produkte te caktuara. Pra sikur kemi cekur me larte keto kerkesa jane ne kundërshtim me legjislacionin e prokurimit. KU OSHP KA NXJERR VENDIM PËR HEQIEN E KËTII KRITERI, Autoriteti Kontraktues tek Kërkesa 1 Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimumB vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme Evidenca 1 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tek Kërkesa 1 Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimumS vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme Evidenca 1 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit Kushti për Master është shumë i ngurtë dhe i papërputhshëm me parimet e Ligjit të Prokurimit Publik Sipas Nenit 26 dhe 29 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, kërkesat për kualifikime duhet të jenë proporcionale, jo diskriminuese dhe të përshtatshme me natyrën e kontratës. Kërkesa për Master universitar në Dizajn të Brendshëm me 5 vite përvojë është tepër specifike dhe përjashton profesionistë të kualifikuar që mund të kenë eksperiencë praktike të konsiderueshme, por jo titullin Master. Kjo kërkesë mund të kufizojë konkurrencën dhe të favorizojë vetëm një kategori të ngushtë profesionistësh Në tregun e punës, ka shumë profesionistë me përvojë të gjatë dhe aftësi të avancuara që kanë tituj të ndryshëm (certifikime profesionale, kurse të avancuara), të cilët nuk do të lejohet të aplikojnë për shkak të këtij kufizimi strikt.Dokumentacioni i kërkuar (kopje diplome, CV, kontrata) mund të jetë i tepruar për vërtetimin e përvojës përvoja dhe kualifikimet mund të vërtetohen edhe me forma më fleksibël si referenca pune ose certifikata profesionale, jo domosdoshmërisht vetëm me kontrata pune që mund të mos jenë të disponueshme në çdo rast andaj kërkojm qe edhe kjo kërkes në fjalë të hiqet. KU OSHP KA NXIERR VENDIM PËR HEQIEN E KËTII KRITERI.

Autoriteti Kontraktues tek Kërkesa 2 Një (1) Baçelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve minimum 2 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme Evidenca 2 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tek Kërkesa 2 Një (1) Baçelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve minimum 2 vite përvojë pune ne fushën e

njëjtë ose të ngjashme Evidenca 2 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit Kushti për Baçelor dhe 2 vite përvojë është i kufizuar dhe mund të mos reflektojë potencialin real të kandidatëve Ligji kërkon që kriteret të jenë të arsyeshme dhe të mos përjashtojnë operatorë me përvojë të konsiderueshme praktike, por pa titullin specifik të Baçelor. Për shembull, kandidatët me diploma të tjera të lidhura ose përvojë të gjatë mund të jenë po aq të aftë. Kërkesa për përvojë minimale 2 vite në fushë të njëjtë ose të ngjashme duhet të jetë më fleksibël Përvoja mund të vërtetohet në mënyra të ndryshme, përfshirë projekte të pavarura, punë freelance, ose certifikata të tjera që nuk kërkojnë domosdoshmërisht kontrata pune. Kërkesa për kopje kontrate si provë mund të jetë e panevojshme dhe penguese. Kërkesat e ngurta për tituj dhe përvojë mund të kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël dhe të rinj që janë të kualifikuar dhe mund të sjellin inovacion Ligji për Prokurimin Publik promovon konkurrencën dhe barazinë, ndaj këto kushte rigoroze mund të jenë të papërshtatshme andaj kërkojm qe edhe kjo kërkes në fjalë të hiqet. KU OSHP KA REKOMANDUAR PËR PËRMISIMIN E KËTH KRITERI.

AK Gjithashtu Autoriteti Kontraktues tek Kërkesa ka kërkuar 3 Një (1) Inxhinier (ose master) i diplomuar i Makinerisë- drejtimi Makineria termoenngjetike me Termoteknike, minimum 10 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Evidenca 3 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Një (1) Inxhinier (ose master) i diplomuar i Makinerisë- drejtimi Makineria termoenngjetike me Termoteknike, minimum 10 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Evidenca 3 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit Në dosjen e tenderit është vendosur kushti që Operatorët Ekonomikë të kenë në staf një inxhinier të diplomuar në drejtimin makineri termoenngjetike me termoteknike. Ky tender ka të bëjë me furnizimin dhe/ose montimin e inventarit të zyrës (mobilje, tavolina, karrige, raftet etj.), i cili nuk përfshin asnjë aktivitet që kërkon njohuri profesionale në fushën e termoenngjetikës apo termoteknikës kjo kërkesë është në kundërshtim me: Nenin 7 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), që përcakton parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Nenin 59 të LPPsë, i cili kërkon që kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale. Vendorsja e një kërkesë për një profil inxhinierik që nuk ka lidhje me natyrën e kontratës kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën duke përjashtuar operatorë që merren realisht me prodhimin/furnizimin e inventarit të zyrës Favorizon në mënyrë të padrejtë operatorë të caktuar që mund të kenë këtë profil në staf, pa arsye teknike të justifikuar. Argumentimi teknik Një inxhinier me drejtim termoenngjetik merret me projektimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes, ftohjes, energjisë termike dhe jo me prodhimin, montimin apo furnizimin e mobiljeve të zyrës Pra ky kriter me këto kërkesa të kërkuara duhet të hiqet menjëher pasi që fare ska të bëjë me furnizimin me inventar prandaj haptas autoriteti kontraktues po e kufizonë konkurrencën ndërsa shumë qartë shihet se janë vendosur për operator ekonomik të paracaktuar andaj kërkojm qe edhe kjo kërkes në fjalë të hiqet. KU OSHP KA NXIERR VENDIM PËR HEQIEN E KËTII KRITERI

Në pikën nr. 4 ka kërkuar që: 4. OE ofertues duhet të ketë Një Inxhinier (ose master) i diplomuar i Elektroteknikes, minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Evidenca 4 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: 4. OE ofertues duhet të ketë Një Inxhinier (ose master) i diplomuar i Elektroteknikes, minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Evidenca 4 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti. Në dosjen e tenderit është vendosur gjithashtu kërkesa për të pasur një inxhinier të diplomuar (ose master) në elektroteknikë me minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme, si dhe dokumentacionin shoqërues (diplomë, CV, kontratë pune ose marrëveshje bashkëpunimi). Ky tender nuk ka asnjë komponent që kërkon njohuri profesionale në fushën e elektroteknikës (projektim apo instalim i sistemeve elektrike, automatizim, etj.). Kjo kërkesë është, po ashtu, në kundërshtim me Nenin 7 të Ligjit të Prokurimit Publik, për parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë. Nenin 59 të LPP-së, sepse kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale. Vendorsja e një kërkesë për inxhinier elektroteknik, në një tender që nuk përfshin punime apo shërbime elektrike, është e pajustificuar teknikisht dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme. Argumentimi teknik inventari i zyrës nuk përmban punime elektrike që kërkojnë licencim ose ekspertizë të nivelit të lartë elektroteknik. Operatorët ekonomikë që merren me prodhimin / furnizimin e mobiljeve nuk kanë nevojë funksionale të kenë në staf një inxhinier elektroteknik me përvojë. Kërkesa duket se nuk është vendosur në bazë të nevojave reale të kontratës, por mund të favorizojë në mënyrë të padrejtë operatorë të caktuar andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet. KU OSHP KA NXIERR VENDIM PËR HEQIEN E KËTII KRITERI.

Në pikën nr. 5 Autoriteti kontraktues ka kërkuar që OE ofertues të ketë Dy (2) Zdrukthëtarose Mobilier të Certifikuar. Evidenca 5 Kopje të Certifikatës dhe Kopjen të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti për një tender për furnizim inventari, veçanërisht nëse nuk ka punime të rëndësishme në vend (prodhim nga e para ose instalim kompleks), kërkesa për zdrukthëtarë apo mobilier të certifikuar është joproporcionale. Shumë operatorë ekonomikë furnizojnë inventar të gatshëm nga prodhues të njohur dhe nuk kanë të punësuar mjeshtrë me certifikata zyrtare, pasi kjo nuk është e nevojshme për furnizim dhe montim bazik.

Sipas Neni 59 i LPP, kriteret duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të mos kufizojnë panevojshëm konkurrencën. Konsiderojmë se kërkesa në fjalë duhet të hiqet pasi që dukshëm po e favorizon një OE të paracaktuar dhe është shkelje e dispozitave të prokurimit publik pasi që OE të tjerë që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë procedurë pamunësohet nga kërkesa në fjalë. Andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet. KU OSHP KA REKOMANDUAR PËR PËRMISIMIN E KËTII KRITERI,

Në pikën 6. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 Evidenca 6 Katalogun nga prodhuesi (ku specifikon sakte prodhuesin) dhe ti nënvizoj në katalog numrin rendor të artikullit. Autoriteti Kontraktues tek kjo kërkesë haptas e kufizon konkurrencën pasi që Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 Evidenca 6 Katalogun nga prodhuesi (ku specifikon sakte prodhuesin) dhe ti nënvizoj në katalog numrin rendor të artikullit dhe Favorizim i qartë i një prodhuesi të vetëm Duke kërkuar katalogun e prodhuesit për artikujt me numra të saktë (58, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 66, 67, 69, 70, 71, 72,73, 75, 76 dhe 80), Autoriteti Kontraktues po orienton pjesëmarrësit drejt një marke apo prodhuesi specifik. Kjo bie ndesh me Nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili ndalon përdorimin e specifikimeve teknike që përshkruajnë produkte të një prodhuesi të caktuar, përveç rasteve kur përdoret termi "ose ekuivalent". Kufizim artificial i konkurrencës Kjo kërkesë eliminon operatorët që ofrojnë produkte ekuivalente me cilësi të barabartë ose më të lartë, duke i mbyllur tenderin furnitorëve të markës së përmendur në mënyrë të tërthortë Neni 7 i LPP kërkon trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të të gjithë operatorëve ekonomikë, gjë që nuk respektohet në këtë rast është bërë Shkelje e parimit të proporcionalitetit Kërkesa për katalog të prodhuesit nuk ka lidhje të domosdoshme me realizimin e kontratës. Ajo nuk është provë unike e përputhshmërisë teknike Përputhshmëria mund të dëshmohej përmes fletë-datave teknike (data sheets) deklaratave të përputhshmërisë nga furnitori Kufizimi vetëm në katalogun origjinal të prodhuesit shkel proporcionalitetin sipas Nenit 59 të LPP. Rrezik i qëllimshëm për tender të mbyllur. Formulimi aktual lë vend për dyshim të bazuar se tenderi është i dizajnuar për një operator të caktuar që ka akses direkt tek prodhuesi i specifikuar OSHP ka vendime të mëparshme ku kërkesa të ngjashme janë anuluar si diskriminuese dhe kufizuese për konkurrencën Të hiqet kushti për katalogun e prodhuesit të saktë. KU OSHP KA NXJERR VENDIM PËR HEOIEN E KËTII KRITERI.

Në pikën 7. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për Specifikat Teknike ku deklaron së i përmbushë specifikat teknike të kërkuara ne Aneksin nr.1 të DT Evidenca 7 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kërkesa 7 pra kërkesa është e pa specifikuar dhe e pa qartë me qëllim të vënies në lajthim të o.e. të interesuar pasi që kjo kërkesë në vetvete është e zakonshme, por duhet të formulohet në mënyrë që operatorit të deklarojë përputhshmërinë me specifikimet pa e kufizuar vetëm në një format të dhënë nga autoriteti kontraktues Nëse deklarata lidhet vetëm me specifikime të hartuar për një markë apo prodhues të caktuar, kjo është diskriminuese sipas Nenit 28 të LPP-së Formulimi aktual nuk garanton që do të pranohen produkte ekuivalente, çka mund të 9/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK kufizojë konkurrencën andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet. KU OSHP KA NXIERR VENDIM PËR HEOIEN EKËTII KRITERI.

Në pikën 8 Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues CE Certifikatat për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69, 70, 71, 72,73,75,76, dhe 80

Evidenca 8 CE Certifikatat. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që 8 Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues CE Certifikatat për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69, 70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 Evidenca 8 CE Certifikatat pra CE nuk është detyrim ligjor për çdo artikull të inventarit të zyrës CE është një shenjë e përputhshmërisë që aplikohet vetëm për produktet që bien brenda direktivave specifike të Bashkimit Evropian (p.sh., direktiva për makineri, pajisje elektrike me tension të ulët, lodra, pajisje mjekësore, etj.) Mobiljet e zakonshme të zyrës (tavolina, karrige, raftë, komodina) nuk kanë detyrim ligjor për CE, përveç rasteve kur kanë elemente elektrike (p.sh., tavolina me prizë të integruar, karrige masazhi, etj.). Kërkesa për CE për çdo artikull, pa e specifikuar bazën ligjore dhe kategorinë e produktit, është e pajustifikuar teknikisht. Është Shkelje e Nenit 59 të LPP - proporcionaliteti CE nuk është kriter universal i cilësisë, por vetëm një tregues ligjor për disa kategori produktesh. Kërkesa e përgjithshme për CE eliminon operatorë që ofrojnë produkte cilësore dhe të sigurta, por që janë prodhuar sipas standardeve të tjera të pranueshme (p.sh. ISO, EN, ANSI/BIFMA, standardet kombëtare). Kjo kufizon panevojshëm konkurrencën dhe nuk është proporcionale me objektin e kontratës. Shkelje e Nenit 7 të LPP - mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë Duke kërkuar CE për çdo artikull, tenderi favorizon furnitorët që kanë akses të prodhues nga BE ose që janë të certifikuar në mënyrë të tillë, duke diskriminuar prodhues lokalë ose nga tregjet e tjera ndërkombëtare ku CE nuk është detyrim ligjor.

Kufizimi vetëm në CE shkel parimin e hapjes ndaj standardeve ekuivalente të përcaktuar në Nenin 28 të LPP-së. Dyshim për kufizim artificial të tregut Vendosija e një kërkesë të tillë pa arsye teknike të bazuar lë vend për dyshim se tenderi është formuluar për të favorizuar operatorë të caktuar që tashmë furnizojnë produkte me CE, duke mbyllur konkurrencën reale. Të hiqet kushti për CE për të gjithë artikujt e inventarit të zyrës dhe të lejohet përputhshmëria të dëshmohet me standarde ose certifikata ekuivalente andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet. KU OSHP KA NXJERR VENDIM PËR HEQJEN E KËTIJ KITERI.

Në pikën 9 Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e liferimit ku deklaron se liferimi i produkteve do të behet jo më vonë se 45 ditë nga data e pranimit të porosisë apo Urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues. Evidenca 9 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi.

Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që 9 Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e liferimit ku deklaron se liferimi i produkteve do të behet jo më vonë se 45 ditë nga data e pranimit të porosisë apo Urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues. Evidenca 9 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE Neni 29 i Ligjit për Prokurimin Publik thekson qartë që afatet e dorëzimit duhet të jenë proporcionale dhe të përshtatshme për natyrën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkesa për afat fikse dhe shumë të shkurtër si 45 ditë mund të kufizojë konkurrencën dhe të mos i lejojë operatorët ekonomikë të përgatiten siç duhet, veçanërisht në rastet kur produktet janë të specializuara, me afat të gjatë prodhimi ose transporti. Ligji kërkon që kriteret teknike dhe kushtet e kontratës të mos jenë diskriminuese dhe të mos favorizojnë një grup të caktuar operatorësh (Neni 26). Kërkesa për afat fikse 45 ditë mund të favorizojë vetëm operatorë që kanë

kapacitete shumë të shpejta dorëzimi, duke përjashtuar operatorët tjerë të cilët mund të kenë produkte me cilësi më të lartë, por afat më të gjatë dorëzimi. Afati i dorëzimit duhet të jetë fleksibël në rastet kur ka ndryshime të paparashikuara në porosi apo situata të jashtëzakonshme. Kërkesa për deklaram strikt për 45 ditë mund të krijojë probleme ligjore në rast vonesash të justifikuara andaj kërkojm qe edhe kjo kërkes në fjalë të hiqet. OSHP 1<A REKOMANDUAR PËR PËRMISIMIN E KËTIJ KRITERI,

Në pikën IO.Operatori Ekonomiksë bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e Garancionit të pajisjeve liferimit ku deklaron së afati garantues do jo ma pak së 12 muaj nga data e pranimi të produkteve nga Autoriteti Kontraktues Evidenca 10 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE. Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që 10 Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e Garancionit të pajisjeve liferimit ku deklaron së afati garantues do jo ma pak së 12 muaj nga data e pranimi të produkteve nga Autoriteti Kontraktues Evidenca 10 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE. Neni 31 i Ligjit për Prokurimin Publik parashikon që kushtet teknike, përfshirë garancitë, duhet të jenë të arsyeshme dhe të përshtatshme për natyrën e produkteve ose shërbimeve që porositen. Një garanci fikse 12-mujore për të gjitha produktet pa marrë parasysh natyrën e tyre mund të jetë e padrejtë dhe e pamjaftueshme për disa produkte, ose e tepruar për disa të tjera. Ligji parandalon vendosjen e kushteve që kufizojnë konkurrencën ose që janë arbitrare. Një garanci fikse 12 muaj mund të përjashtojë operatorët që ofrojnë produkte me afat garancie më të shkurtër, por me çmim më të mirë, duke dëmtuar konkurrencën. Në bazë të parimit të transparencës dhe barazisë në procedura, kërkesa për garanci duhet të jetë e qartë dhe e arsyeshme, dhe jo të imponojë kusht të njëjtë për të gjitha llojet e produkteve pa dallim andaj kërkojm qe edhe kjo kërkes në fjalë të hiqet. OSHP KA REKOMANDUAR PËR PËRMISIMIN E KËTIJ KRITERI.

Kërkojm nga ju si Autoritet Kontraktues që ti heqni kriteret diskriminuese sepse ne si palë e pa kënaqur kemi për të parashtruar edhe Ankesë në OSHP si dhe këtë kërkesë për heqjene e kriterëve diskriminuese ne do ta paraqesim edhe pran organeve tjera kompetente në raste se nuk beni heqjen e kriterëve diskriminuese. Andaj, Kërkojmë që në përputhje me dispozitat e LPP-së të lartcekura të mënjaroni kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe të zgjatni afatin për dorëzimin e ofertave përndryshe jemi të detyruar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe do ti njoftojmë organet tjera kompetente.

Ankesa mbështetet në dispozitat e mëposhtme ligjore: • Neni 7 - Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit; • Neni 26 - Parimet e transparencës dhe proporcionalitetit; • Neni 28 - Specifikimet teknike dhe ndalimi i kufizimeve të pajustificuara; • Neni 29 - Kriteret e përzgjedhjes dhe kualifikimit; • Neni 131 - Zbatimi i vendimeve të OSHP-së dhe masat ndëshkuese; • Neni 422 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. 1. Pranohet ankesa si e bazuar dhe e ligjshme. 2. Konstatohet moszbatimi i vendimit të OSHP-së nr. 2025/0788 nga Komuna e Prishtinës. 3. Anulohet dosja e re e tenderit e publikuar më 10.10.2025.4. Pezullohet menjëherë procedura e prokurimit deri në shqyrtimin

përfundimtar të ankesës. 5. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të korrigjojë dosjen në përputhje me dispozitat ligjore. 6. Fillohen procedura disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit për moszbatim të vendimit. Bazuar në nenin 131 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kërkohet nga OSHP dhe KRPP: 1. Pëzullimi i menjëhershëm i certifikatave të zyrtarëve të prokurimit të përfshirë në këtë rast deri në përfundimin e hetimeve. 2. Revokimi i përhershëm i certifikatave për shkak të shkeljeve të përsëritura dhe veprimeve të qëllimshme që bien ndesh me parimet e LPP-së. 3. Inicimi i procedurave penale ndaj zyrtarëve për keqpërdorim të pozitës zyrtare në kundërshtim me nenin 422 të Kodit Penal. 4. Njoftimi i Prokurorisë së Shtetit, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe EULEX-it për hetim dhe monitorim. Gjithashtu, vërehet se të njëjtët zyrtarë tëprokurimit: Visar Shehu & Qendrim Berbatovci kanë publikuar vazhdimisht procedura të ngjashme me kriteret të njëjta diskriminuese, duke bërë të ditur se Autoriteti Kontraktues është vënë në lajthitje nga Operatori ekonomik Wood Corporation pasi që të gjithë tenderët për furnizim me inventar për zyre I pregadis dhe I fiton OE Wood Corporation si dhe AK dhe OE dëmtojnë rendë buxhetin e qytetarëve për praktika të përsëritura të favorizimit të një operatori të caktuar ekonomik në kundërshtim me nenet 7, 26 dhe 28 të LPP-së. Kjo sjellje tregon mungesë të transparencës dhe përbën shkelje të parimeve të konkurrencës së ndershme. Prandaj, kërkohet nga OSHP, KRPP dhe organet e hetuesisë që të shqyrtojnë të gjitha procedurat e fundit të shpallura nga këta zyrtarë dhe të verifikojnë se ekzistojnë lidhje të interesit ndërmjet tyre: Visar Shehu & Qendrim Berbatovci, Komuna e Prishtinës dhe operatorit ekonomik Wood Corporation. Kërkohet që organet kompetente, përfshirë Prokurorinë e Shtetit dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, të ndërmarrin hetime të pavarura për të vërtetuar nëse kemi të bëjmë me veprime të qëllimshme që mund të përbëjnë shkelje të nenit 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “HM Home” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Kjo ankesë bazohet në dispozitat e mëposhtme të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës: -Neni 7 - Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit; -Neni 26 - Parimi i proporcionalitetit; -Neni 28 - Specifikimet teknike; -Neni 29 - Kriteret e përzgjedhjes dhe kualifikimit; -Neni 131 - Zbatimi i vendimeve të OSHP-së; si dhe në Rregulloren (AOI) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në faktet, provat dhe argumentet e paraqitura, HM HOME SH.P.K. lutet që OSHP: •Ta pranojë këtë ankesë si të bazuar dhe të ligjshme; •Të urdhërojë anulimin e vendimit të Komunës së Prishtinës nr. 17.10.2025; •Të marrë masa të menjëhershme për korrigjimin e dosjes së tenderit në përputhje me vendimin OSHP nr. 2025/0788; •Të nisë hetime institucionale dhe disiplinore për zyrtarët e prokurimit dhe operatorët ekonomikë që kanë shkelur parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit; •Të sigurojë revokimin e përhershëm të certifikatave të zyrtarëve të prokurimit që kanë shkelur ligjin; •Të garantojë që procedurat e mëtejshme të prokurimit të kryhen në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurim Publik dhe standardet e OSHP-së, duke parandaluar çdo favorizim të paligjshëm.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori ekonomik "HM Home" (tutje "parashtruesi") me datë 15.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7

shtatori" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Operatori ekonomik HM HOME SH.P.K. parashton këtë ankesë lidhur me moszbatimin e vendimit të OSHP-së nr. 2025/0788, përmes të cilit ishte urdhëruar Autoriteti Kontraktues që brenda afatit prej 10 ditësh të korrigjonte dosjen e tenderit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Në kundërshtim me këtë vendim, Komuna e Prishtinës ka publikuar më 10.10.2025 dosjen e re me të njëjtat kritere diskriminuese dhe joproporcionale, duke treguar qëllim të qartë për të anashkaluar vendimin e OSHP-së dhe për të kufizuar konkurrencën e ndershme".

Lidhur me pretendimet duhet cekur se Komuna e Prishtinës e ka pranuar vendimin e OSHP me shenjë 2025/0788 të datës 06.10.2025. Mirëpo në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi thuhet si vijon "2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Lejohet AK të vazhdojë me procedurën e prokurimit". Prandaj pretendimi ankimor i parashtruesit nuk qëndron për faktin që OSHP nuk ka kërkuar nga AK që të ndryshoj DT por e ka vërtetuar dosjen e tenderin në formën siç është, për më tepër e ka autorizuar AK po ashtu që të vazhdojë tutje me procedurën e prokurimit. Pra DT është përputhje të plotë me vendimin e OSHP 2025/0788 të dt. 06.10.2025.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim të parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.10.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1040/2025, ndërsa me datë 02.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/1040 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të

aprovohet i bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që AK të bëjë shtyerjen e afatit për ofertim në pajtim me dispozitat e LPP-së, duke bërë paraprakisht korrigjimet e dosjes së tenderit sipas përgjigjeve në Pretendimet ankimore të këtij raporti.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, AK nuk pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “HM Home” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1040 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 3: Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me ISO Certifikatat valide ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata

Evidenca3: Certifikatat valide ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me ISO Certifikatat valide ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata ndërsa si evidencë/deshmi Certifikatat valide ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018. Në rast të grupit të OE, mjafton që njëri nga anëtarët e grupit të OE të jetë I pajisur me këto ISO Certifikata, mendon që kërkesa në dosjen e tenderit për ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018 përveç ISO 9001:2015 që është në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit pasi që ISO 9001:2015 është për Menaxhim të cilësisë dhe e njëjta është gjenerale ndërsa ISO 14001-2015 dhe ISO 45001-2018 nuk përkon me natyrën e aktivitetit të prokurimit pasi që këto ISO nuk kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë dhe për mendimin e

ekspertit shqyrtues keto dy ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 jane te pa nevojshme pasi qe kufizon konkurrencen në pjesëmarrjen e Operatorë Ekonomik e që është në kundërshtim me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet të jete i Autorizuar nga Prodhuesi për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65, 66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80.

Evidenca 4 Autorizim nga Prodhuesi -kopje:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Operatori Ekonomik duhet të jete i Autorizuar nga Prodhuesi për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65, 66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 ndërsa si evidencë/dëshmi Autorizim nga Prodhuesi -kopje mendon se kërkesa për autorizim nga prodhuesi nuk është në harmoni me LPP-në, pasi qe është kërkuar vetëm autorizim nga prodhuesi duke mos lenë hapësirë edhe autorizimin nga distributori/dileri i autorizuar i prodhuesit, pasi qe kufizon konkurrencen në pjesëmarrjen e Operatorë Ekonomik e që është në kundërshtim me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik si dhe paragrafi 5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik.

Per mendimin e ekspertit ky kriter i Autorizimit nga Prodhuesi duhet të modifikohet duke përfshirë edhe distributorin/dilerin.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 1: Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimum 5 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme

Evidenca 1: Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimum 5 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme ndërsa si evidencë/dëshmi Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit, mendon që kërkesa në dosjen e tenderit është në harmoni me natyrën e aktiviteti të prokurimit pasi që të inventarit dizajneri i brendshme benë planifikimin e hapësirës se brendshme, organizimin e dhomave, zyreve korridoreve dhe hapësirave tjera të objektit, përcakton ngjyrat, hapësirat te jenë me ndriçim si dhe pune tjera. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues kërkesa vetëm me Master është kërkesë kufizuese pasi qe te njëjtën punë mund te kryej edhe inxhinieri bachelore me një përvojë minimum prej 2 vite dhe me këtë do të trajtohen të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për këtë aktivitet në mënyrë të barabartë duke mos diskriminuar apo reduktuar konkurrencën. Po ashtu edhe dëshmitë e kërkuara si diploma kopje, CV dhe kontrata ose marrëveshje bashkëpunimi janë ne harmoni me LPP pasi qe sipas kërkesës se kërkuar duhen dokumentet si dëshmi. Në lidhje me këtë pretendim ankimor kriteri të modifikohet me minimum bachelor dhe përvojë pune minimum 2 vite.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 2 Një (1) Baçelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve minimum 2 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme

Evidenca 2 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Një (1)Baçelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve minimum 2 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme ndërsa si evidencë/dëshmi Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit, mendon që kërkesa në dosjen e tenderit është në harmoni me natyrën e aktiviteti të prokurimit pasi që inxhinieri i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve benë planifikimin e hapësirës se brendshme, organizimin e dhomave, krijimi i mjediseve funksionale dhe estetike, zhvillim i ideve për modele te reja te mobiljeve, përshtatja e mobiljeve sipas hapësirave, punon me inxhinier, me prodhues të mobiljeve. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues kërkesa në 2 vite përvojë të punës, pervoja e

punes deshmohet me reference ku inxhinieri duhet te deshmon se ka punuar ne ndermarrje/kompania te ndryshme mbi pervojen e punes duke specifikuar pervojen ne CV-ne dhe është kërkesë minimale që të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për këtë aktivitet janë të barabartë duke dëshmuar me kopje diplomën, CV si dhe kontratën e punës ose marrëveshje te bashkëpunimit janë ne harmoni me LPP-në pasi qe sipas kërkesës se kërkuar duhen të dokumentohen me dëshmi.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 3 Një (1) Inxhinier (ose master) i diplomuar i Makinerisë- drejtimi Makineria termoenengjetike me Termoteknike, minimum 10 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme.

Evidenca 3 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Një (1) Inxhinier (ose master) i diplomuar i Makinerisë- drejtimi Makineria termoenengjetike me Termoteknike, minimum 10 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme ndersa si evidencë/deshmi Kopje të Certifikatës dhe Kopjen të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti, mendon që kërkesa në dosjen e tenderit nuk është në harmoni me natyrën e aktiviteti të prokurimit pasi që një kërkesë e tille nuk përkon me natyrën e aktivitetit të prokurimit pasi sipas aneksit 1 të dosjes se tenderit kemi te bëjmë me inventarë te llojeve të ndryshëm si me artikuj si tavolina të llojeve te ndryshme, dollapë për zyre të llojeve te ndryshme, karrika të llojeve te ndryshme, ulëse të llojeve, jastëk, komode te ndryshme, banka të klasës, pajisje të ndryshme për kuzhine, enëlarëse, rrobatharese. Sipas kësaj kërkesë në këtë aktivitet te prokurimit do ti ishte në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 paragrafi 6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së, nenin 51 si dhe me nenin 69 të LPP, dhe e njëjta mundet qe te jetë diskriminuese për Operatoret Ekonomik tjerë furnizues me inventarë.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 4 Një Inxhinier (ose master) i diplomuar i Elektroteknikes , minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme Evidenca 4 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Një Inxhinier (ose master) i diplomuar i Elektroteknikes , minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme ndërsa si evidencë/deshmi Kopje të Certifikatës dhe Kopjen të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti mendon që kërkesa në dosjen e tenderit nuk është në harmoni me natyrën e aktiviteti të prokurimit pasi që një kërkesë e tillë nuk përkon me natyrën e aktivitetit të prokurimit pasi sipas aneksit 1 të dosjes se tenderit kemi te bëjmë me inventarë te llojeve të ndryshëm si me artikuj si tavolina të llojeve te ndryshme, dollapë për zyre të llojeve te ndryshme, karrika të llojeve te ndryshme, ulëse të llojeve, jastëk, komode te ndryshme, banka të klasës, pajisje të ndryshme për kuzhine, enëlarëse, rrobatharëse. Sipas kësaj kërkesë në këtë aktivitet të prokurimit do të ishte në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 paragrafi 6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së, nenin 51 si dhe me nenin 69 të LPP, dhe e njëjta mundet që të jetë diskriminuese për Operatorët Ekonomik tjerë furnizues me inventarë.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 5 Dy (2) Zdrukthëtar ose Mobilier të Certifikuar

Evidenca 5 Kopje të Certifikatës dhe Kopjen të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Dy (2) Zdrukthëtar ose Mobilier të Certifikuar ndërsa si evidencë/deshmi Kopje të Certifikatës dhe Kopjen të kontratës së punës ose para kontratës - marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të prokurimit të këtij projekti, mendon që kërkesa në dosjen e tenderit nuk është në harmoni me neni 7 paragrafi 6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe

specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së pasi që AK ka mundur që përveç Certifikatës të kërkojë edhe diplomë profesionale apo ndonjë dokument tjetër ku dëshmohet që ka diplomë/certifikat për zdrukthëtar ose Mobilieri që përkon me natyrën e aktiviteti të prokurimit. Në lidhje me këtë pretendim ankimor kriteri të modifikohet duke kërkuar edhe diplome apo ndonjë dokument tjetër.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.8

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 6. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80

Evidenca 6 Katalogun nga prodhuesi (ku specifikon sakte prodhuesin) dhe ti nënvizoj në katalog numrin rendor të artikullit:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor për kërkesën Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69,70, 71, 72,73,75,76, dhe 80 ndersa si evidencë/deshmi Katalogun nga prodhuesi (ku specifikon sakte prodhuesin) dhe ti nënvizoj në katalog numrin rendor të artikullit, mendon që kjo kërkesë është legjitime në procedurat e prokurimit publik të kerkohet katalog nga prodhuesi pasi që ndihmon Autoritetet Kontraktues që të vlerësojë pajtueshmërinë e ofertës së dorëzuar nga OE me specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Nuk bie ndesh me parimet e pabarazisë, nëse është e qartë dhe e arritshme për të gjithë operatorët ekonomikë pasi që të gjithë prodhuesit kanë katalog për produktet që i prodhon. Kjo pikë është i pa bazuar.

Sa i perket pretendimit ankimor se bie ndesh me nenin 28 të LPP-së e i cili ndalon përdorimin e specifikimeve teknike që përshkruajnë produkte të një prodhuesi të caktuar, përveç rasteve kur përdoret termi “ose ekuivalent”. Pas analizimit të specifikacioneve teknike për artikujt me numer rendor që është kërkuar katalogu nga prodhuesi, specifikat teknike janë në kundërshtim me nenin 28 Specifikimet teknike të LPP-së pasi që specifikat teknike për këta artikuj janë hartuar me dimensione/madhësi fikse duke mos lenë tolerancë në dimensionet e kërkuara (minimum, maksimum ose plus minus në përqindje). Sipas nenit 28 Specifikimet teknike paragrafi 2. Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paragrafi 7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”. Po ashtu edhe sipas Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024, Neni 19 Specifikimet Teknike paragrafi 19.6 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme/ekuivalente”. Specifikacionet teknike duhet të kenë tolerancë si minimum/maksimum apo plus minus në përqindje dhe kjo pikë është e bazuar.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur më lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.9

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 7. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për Specifikat Teknike ku deklaron së i përmbushë specifikat teknike të kërkuara në Aneksin nr.1 të DT

Evidenca 7 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për Specifikat Teknike ku deklaron së i përmbushë specifikat teknike të kërkuara në Aneksin nr.1 të DT, mendon që kjo kërkesë ka të bëjë me Deklaratën për Specifikat Teknike e cila deklaratë është konforme dosjes së tenderit sipas Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FDT) përshkrimi i neni 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme neni 3.1. AK këtë deklaratë e ka vendosur si kriter në dosjen e tenderit neni 9.1&9.2 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur më lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.10

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 8. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues CE Certifikatat për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69, 70, 71, 72,73,75,76, dhe 80

Evidenca 8 CE Certifikatat:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues CE Certifikatat për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69, 70, 71, 72,73,75,76, dhe 80, mendon që kjo kërkesë është kërkuar vetëm për artikujt e lart shënuar që janë pajisje për kuzhinë. Sipas ekspertit shqyrtues në lidhje me pajisjet që kërkohet certifikata CE sipas mendimit të ekspertit shqyrtues kjo certifikatë kërkohet për pajisje mbrojtëse personale (helmetë, maska, doreza), pajisje mjekësore, makineri pune, pajisje elektrike dhe elektronike. Në pajisjet elektrike dhe elektronike hyjnë edhe pajisjet e kuzhinës ku sipas numrit rendor të artikujve të kërkuar janë këta artikuj si në vijim: art 58. Cooker/Sobë; art 59. Grill /Skarë; art 60. Deep fat fryer/Fergues; art 64. Pizza refrigerator, Marble top/Frigorifer me tavoline per pica; art 65. Pizza Oven/Furre e picave; arti 80 Dishwasher/Enelare ndërsa artikujt art 62.Work table/Tavoline e punës; art 66. Wall shelf / Raft muri; art 67. Dishwasher /Lavaman; art 69. Work table/Tavoline e punës; art 70.Karroçë për përbërës; art 71.Work Table /Tavoline pune; art 72. Tavolinë pune për kuzhinë; art 73. Wall Cupboard/Raft mur; art 75. Wall shelf/ Raft muri; art 76. Double sink table/ Lavaman me dy vrima janë pajisje që nuk kërkohet certifikatën CE pasi që këta artikujt nuk janë pajisje elektrike dhe elektronike dhe për keta artikuj nuk duhet të kërkohet certifikatën CE që do të ishte në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 paragrafi 6 pika (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; dhe (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik të LPP-së, nenin 51 si dhe me nenin 69 të LPP-së dhe e njëjta mundet që të jetë diskriminuese/ kufizuese për Operatoret Ekonomik. Certifikata CE duhet të kerkohet vetem per pajisje elektrike dhe elektronike dhe ky kriter duhet të modifikohet.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.11

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 9. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e liferimit ku deklaron së liferimi i produkteve do të behet jo ma vone së 45 dite nga data e pranimit të porosisë apo Urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues.

Evidenca 9 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore për kërkesën Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e liferimit ku deklaron së liferimi i produkteve do të behet jo ma vone së 45 dite nga data e pranimi të porosisë apo Urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues, mendon qe kjo kërkesë ka të beje me dorëzimin e mallrave me leshuarjen e urdhër blerjes nga AK. OE pretendon se janë shkelur neni 26 dhe 29 i Ligjit të Prokurimit Publik sipas mendimit të ekspertit shqyrtues këto nene nuk kanë të bëjnë afatin e liferimit por kanë te bëjnë si neni 26 nënshkrimi i kontratës si dhe neni 29 Variantet e specifikimeve teknike.

Duke ju referuar dosjes se tenderit përkatësisht lista prej 103 artikujve të ndryshëm për mendimin e ekspertit shqyrtues është një afat i shkurtër prej 45 ditë pasi qe duhet llogaritur prodhimin nga prodhues të ndryshëm, transportin, montimin do te ishte një afat me i arsyeshme qe te rritet afati i liferimit per disa ditë që do ta përcaktonte AK në mënyre qe edhe të mos penalizohet kontraktuesi për vonesën e liferimit të mallit.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.12

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si në vijim:

Kërkesa 10. Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e Garancionit të pajisjeve liferimit ku deklaron së afati garantues do jo ma pak së 12 muaj nga data e pranimi të produkteve nga Autoriteti Kontraktues

Evidenca 10 Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i OE:

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimore per kërkesën Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Deklaratën për afatin e Garancionit të pajisjeve liferimit ku deklaron së afati garantues do jo ma pak së 12 muaj nga data e pranimi të produkteve nga Autoriteti Kontraktues, mendon qe kjo kërkesë është në harmoni me dosjen e tenderit përkatësisht te PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME sipas Neni 24 Obligimet për garanci paragrafi 24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm. Nga kjo edhe ne rastet kur nuk është kerkuar si kriter Garacioni të Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FDT) do të vlen periudha garantuese sipas Kushteve te përgjithshme neni 24 paragrafi 24.5 përveç nëse kërkohet ndryshe te kushtet e veçanta të kontratës. AK ka kërkuar garancionin si kriter ku OE pjesëmarrës së bashku me ofertë do te dorëzojnë Deklaratën për garancion siç është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Duke u mbështetur në sqarimet e lartpërmendura nga eksperti teknike, eksperti shqyrtues mendon që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues është i bazuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenive të lart përmendur të LPP-së për shkak të kriterëve diskriminues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

PPaneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues, PSH nuk ia fal besimin ekspertit shqyrtues, pasi i njëjti nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të mjaftueshme për të na siguruar se ndryshimi i kërkesave të parashtruara në DT nga ana e AK do të mundësonte arritjen e qëllimit të caktuar të këtij aktiviteti.

PSH konstaton se të gjitha kërkesat e DT janë të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit dhe se këto kërkesa janë në përputhje të plotë me LPP-në. Po ashtu, PSH konstaton se AK ashtu siç ka obligim ka zbatuar me përpikëri dispozitat ligjore të nenit 10, paragrafi 10.3 të RRPP-së, i cili përcakton se njësi kërkuese, ndër të tjera, ka përgjegjësinë për përgatitjen e specifikimeve teknike, termave të referencës, paramasës dhe parallogarisë.

Gjithashtu, PSH konstaton se AK ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 11, paragrafi 11.3 të RRPP-së, të cilat rregullojnë në mënyrë decizive bashkëpunimin ndërmjet zyrtarit të prokurimit dhe njësisë kërkuese, duke përfshirë koordinimin e dokumenteve, projekteve, specifikimeve teknike, termave të referencës, paramasave etj.

Paneli shqyrtues, në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional, ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shkollës 7 Shtatori – Inventarizimi”, me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar, kështu duke mos pasur baze të mjaftueshme ligjore që për të njëjtin të kërkojë përmirësim të dosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që ankesën e OE ankues ta aprovoj si pjesërisht të bazuar ndërsa i lejohet vazhdimi i procedurës AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi” me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HM Home SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: